



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____ .2023

VENDIM

Nr. 220, datë 28.04.2023

PËR

**TRANSFERIMIN E GJYQTARIT {...}, NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM LEZHË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 4 dhe 147/1/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 42 dhe 44/2B të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, referuar Vendimit nr. 215 datë 28.04.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi shqyrtoi zgjedhjen për tu transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel, të gjyqtarit z. {...}, mbi propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Transferimin e gjyqtarit z. {...}, në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Lezhë, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë ku është caktuar në mënyrë të përhershme.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.05.2023.
3. Gjyqtari {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake ashtu edhe seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër i caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dorëzohen menjëherë prej tij.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatës së rrethit gjyqësor Shkodër.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR